



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BERAT CITY GREEN – BCG SH.A

Nr. _____ Prot.

Data ____ . ____ . 2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Ndertim parkimi per mjetet e pastrimit dhe streh per qente ne landfillin Berat »

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45210000-2 punime ndertimi

VLERA E FONDIT LIMIT fond limit: 4 778 513.42 (kater milion e shtateqind e shtatedhete e tete mije e peseqind e trembedhete presje dyzete e dy) leke pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor BERAT CITY GREEN – BCG SH.A ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës8,*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës3; ;.*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Argumentim:kerkesa e mesiperme bazohet ne nenin 77, pika1/a dhe 2, ne LPP. nenin 39 pika 6/p te VKM,nr285, date 12.05..2021, "Per miratimi e rregullave te prokurimit publik ".

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BERAT CITY GREEN – BCG SH.A

2.2.1. Operatorët ekonomik duhet të paraqesin bilancet vjetore, për 3 vitet e fundit financiare (2021, 2022 - 2023) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore, të konfirmuara nga ky autoritet. Nëse operatori ekonomik ofertues është në kushtet e parashikuara nga neni 41, pika "c", e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 "*Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar*" i ndryshuar, atëherë secili bilanc duhet të shoqërohet me akt-ekspertizen e kryer nga eksperti kontabel.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentim: kërkesa e mesipërme bazohet në nenin 77, pika 3, në LPP. nenin 43 të VKM, nr.285, date 12.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2.2. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimin për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Përvojë të suksesshme në zbatimin e punimeve të ndërtimit:

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, të jetë në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentat e mëposhtme:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BERAT CITY GREEN – BCG SH.A

i) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik, duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve:

1. Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës nr.9, shoqëruar me:
2. Kontratën/at e Sipërmarrjes;
3. Situacionin përfundimtar të objektit;

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktoje saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

ii) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kontratën/at e Sipërmarrjes;
2. Situacionin përfundimtar të objektit;
3. Fatura tatimore përfundimtare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës që prokurohet.

2.3.1 Licenca profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës.

2.3.2/a Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktues dhe Energjisë, ne baze te VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme :

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:

- **N.P - 1 A** (Punime germimi ne toke)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BERAT CITY GREEN – BCG SH.A

- **N.P - 2 A** (Ndertime civile dhe industriale)

Për punimet speciale të ndërtimit:

- **N.S - 8 A** (Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri)
- **N.S - 18 A** (Punime topogjeodezike)
- **N.S - 20 A** (Shpime gjeologjike-inxhinierike, puse e shpime per uje)

Shënim: Operatorët e huaj duhet të kenë kryer ekuivalentimin (njehsimin) e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë institucionit përkatës siç përcaktohet në “Rregulloren për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” e miratuar me VKM – në Nr. 42, datë 16.01.2008 ”Për miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Mos paraqitja në këtë formë është kusht s’kualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: ”Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga organet kompetente shtetërore.”, si dhe në klasifikimin e niveleve (gërmave) për punimet sipas natyrave respektive, të parashikuara në VKM Nr.42 date 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
---------------------	--	--	---	--



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BERAT CITY GREEN – BCG SH.A

N.P - 1 A	Punime germimi ne toke	Germim themele e plinta	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr 42 date 16.01.2008, i ndryshuar.
N.P - 2 A	(Ndertime civile dhe industriale)	Ndertim konstruksion metalik (kapanon)	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr 42 date 16.01.2008, i ndryshuar.
N.S - 8 A	Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri	Konstruksione metalike, mbulim catie	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr 42 date 16.01.2008, i ndryshuar.
NS - 18A	Punime topogjeodezike.	Lidhet me piketimin e objektit, kuotat per sitemimin e sheshit etj.	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr 42 date 16.01.2008, i ndryshuar.
NS – 20 A	Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime per uje	Shpim pusi 30-40m	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr 42 date 16.01.2008, i ndryshuar

2.3.2 Dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik :

a. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- Inxhinier Ndertimi 1 (nje)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BERAT CITY GREEN – BCG SH.A

- Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë - 1 (një) Inxhinier Topograf/Gjeodet me kontrate pune ose kontrate bashkepunimi.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik per secilin pjesetar te stafit teknik duhet te paraqese:

Kontratë pune/, Diplomën Universitare,

(Drejtuësit teknik te jene te siguruar sipas legjislacionit ne fuqi

- **Inxhinieri i ndertimit** eshte pergjegjes per zbatimin e sakte te punimevete objektit qe prokurohet per secilin nga zerat e punimeve ndertimore referuar preventivit.
- **Inxhinieri Topograf Gjeodet** eshte pergjegjes per zbatimin e sakte te kuotave te projektit objekt prokurimi.
- **Argumentimi:** Së pari, kjo kërkesë mbështetet ne Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejten të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarinimin e mësipërm.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet disponoje punonjës të specializuar/ kualifikuar si më poshtë:

- 1 (një) punonjës që disponon certifikatën si **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit ne pune”** në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.

Argumentimi : Kërkesa e shkronjës d) të pikës 2.3.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim, është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BERAT CITY GREEN – BCG SH.A

kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht :

Kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullore “Për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

2.3.4 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë :

- Teknik Ndertimi	1 (nje)
- Elektracist	1 (nje)
- Hidraulik	1 (nje)
- Specialist ndertimi	1 (nje)
- Saldator	1 (nje)
- Hekurkthyes	1 (nje)
- Punonjes te specializuar per punime ne lartesi	1 (nje)
- Punetor te thjeshte ndertimi	2 (dy)

Për punonjësit e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë :

- kontratën individuale të punës;
- Certifikata/diploma për formimin profesional (të vlefshme), të cilat duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh. ”, i ndryshuar, si edhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë për muajin e fundit.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, ose nëse do të jetë nevojë për tu kërkuar sqarime nga AK.

- **Argumentimi:** Së pari, kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BERAT CITY GREEN – BCG SH.A

miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”. Konkretisht:

- **Tekniku i ndertimit** eshte i nevojshem per ndjekjen e realizimin te punimeve te ndertimit, sipas zerave te preventivit.
- **Saldatori** eshte i nevojshem per saldimin e pjeseve te konstruksioneve metalike.
- **Elektricist** jane te nevojshem gjate gjithë periudhes se realizimit te punimeve per punimet elektrike.
- **Punetoret e lartesisë** jane te nevojshem per punime ne lartesi per mbulimin e catise.
- **Hekurkthyesit** Jane te domozdoshem ne objekt per punimin edhe lidhjen e hekurit gjate gjithë struktures.
- **Hidraulik** jane te nevojshem gjate gjithë periudhes se realizimit te punimeve per punimet hidraulike.
- **Specialist ndertimi** jane te nevojshem gjate gjithë periudhes se realizimit te punimeve per punimet e betonimit, mure.
- Punetor te thjeshte ndertimi jane te nevojshem gjate gjithë periudhes se realizimit te punimeve per punimet e tjera sipas preventivit.

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të dëshmojnë se kanë të punësuar në stafin e shoqërisë punonjës të kualifikuar, të pajisur me Dëshmi të Aftësive Profesionale (DAP), lëshuar nga D.P.SH.T.RR., minimalisht si më poshtë :

Manovrator 1 (nje)

Shoferi 1 (nje)

(Në rastet kur mjetet/makineritë disponohen me qera, keta punonjës mund të jenë të kontraktuar).

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- Kontratat e punës të vlefshme;

- Dokument (dëshmi kualifikimi profesional), që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike te kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshnisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjetikës.

Shenim. Kjo kerkese permbushet nepermjet plotesimit dhe paraqitjes nga operatoret ekonomike te formularit permbledhes te vetedeklarimit, sipas shtojces 8 te DST.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BERAT CITY GREEN – BCG SH.A

Dokuntacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 12 (dymbëdhjete) punonjës. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Ndërsa ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, duhet të dorëzoj pranë autoritetit kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK, dokumentacionin si më poshtë:

- *Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për muajin e fundit.*
- *Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit.*

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8 të DST.

Shenim: *Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet : “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.*

Argumentim: *Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.*

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës,që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratën. Numri i punonjësve, tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BERAT CITY GREEN – BCG SH.A

për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.

2.3.6 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës :

1	Kamion vetë shkarkues , kapaciteti mbajtës jo më pak 18 ton	1 cope	Pronësi ose me qera
2	Kamiocina	1 copë	Pronësi ose me qera
3	Minieskavator	1 copë	Pronësi ose me qera
4	Kamion me vinc	1 copë	Pronësi ose me qera
5	Sond Shpimi	1 cope	Pronësi ose me qera
6	Betoniere kantieri	1 cope	Pronësi ose me qera
7	Depozite uji	1 copë	Pronësi ose me qera
8	Matrapik	1 copë	Pronësi ose me qera
9	Vibrator betoni	1 copë	Pronësi ose me qera
10	Gjeneratore	1 copë	Pronësi ose me qera
11	Saldatrice	1 copë	Pronësi ose me qera

Ofertuesi për makineritë, të cilat janë në pronësi ose me qera, duhet të paraqesë, dokumentacionin e mëposhtëm :

Për mjetet që janë në pronësi, duhet të paraqitet :

- dokumenti që vërteton pronësinë (çertifikatën e pronësisë së mjetit rrugor);
- dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
- çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS);
- siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- leje transporti nga bashkia;
- foto të mjetit ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BERAT CITY GREEN – BCG SH.A

Kur janë me qera, duhet të paraqitet :

- a) kontrata e qerasë e vlefshme;
- b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
- c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS);
- d) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- e) leje transporti nga bashkia;
- f) foto të mjetit ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij.

Për mjetet apo pajisjet e tjera që nuk pajisen me leje qarkullimi, ofertuesi duhet të paraqesë kontratë noteriale të blerjes ose fatura tatimore të blerjes ose dokument zhdoganimit të mjetit dhe foto të tyre.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

- **Kamiona vetshkarkues** duhen për transportin e dherave në objekt.

- **Minieskavator** është i nevojshëm për sistemimin dhe hapjen e vendit ku do të ndërtohet objekti.

- **Kamion me vinc** është i nevojshëm për transportin dhe shkarkimin e materialeve hekur, cimento dhe ngritjen e konstruksioneve të renda.

- **Sonda e shpimit**, është mjaft e domozdoshme për shpimin e poshit.

- **Betoniëri kantieri** është e domozdoshme për punime betoni në Objekt sipas zerave të preventivit.

- **Matrapik**, është i domozdoshëm për tjerjen e elementeve.

- **Vibrator betoni** është i domozdoshëm për vibrimin dhe ngjeshjen e betonit.

- **Depozite uji** është e domozdoshme për sigurimin e ujit në objekt e ndërtimit.

- **Saldatrice** është e domozdoshme për saldimin, drejtimin, bashkimin e detajeve të ndryshme me bashkimin e objekteve të madhesive dhe formave të ndryshme duke përdorur mjetet dhe pajisjet e duhura.

Argumentimi: Kërkesat e mesipërme janë vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe Nenit 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BERAT CITY GREEN – BCG SH.A

Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

2.3.7 Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë si dhe të shëndetit e sigurisë në punë. Për këtë duhet të paraqesin certifikatat e mëposhtme:

ISO 9001:2015 Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë (ose ekuivalente)

ISO 14001:2015 Sistemet e Menaxhimit Mjedisor (ose ekuivalente)

ISO 45001:2018 Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë (ose ekuivalente)

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

***ISO 9001:2015** është ne seri normash dhe standartizimesh nderkombetare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t'i adoptojnë për një orientim me të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogelimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.*

***ISO 14001:2015** ofron një kuader praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BERAT CITY GREEN – BCG SH.A

biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Për ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

***ISO 45001-2018** është standard ndërkombëtar, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt*

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Njesia e Prokurimit

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Besnik BODE